




FKPKK

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, Shqipëri

www.shkpkk.org



APPK

Asosacioni i Pronarëve të Pyjeve Privatë, Kosovë

www.akppp.org

Kurora e Gjelbër

Gazetë Periodike, Tiranë (Viti i katërbëdhjetë i botimit) Nr. 118, korrik 2012 Çmimi 20 lekë

Riorientimi për permirësimin e reformave për pyjet e kullotat komunale

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale, në bashkëpunim me SNV-Shqipëri dhe mbështetur nga shumë organizata e shoqata të tjera, me 20 qershor 2012 organizoi një tavolinë të rrumbullakët, ku u diskutua për zhvillimin e reformave për pyjet komunale. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i gjetjeve nga studimet dhe praktikat e derisotme, si dhe konkretizimi i hapave, që duhet të ndërmerren për vazhdimin e reformave (transferimi, regjistrimi, permirësimet ligjore), për të siguruar qëndrueshmërinë e pyjeve dhe kullotave.

Pas federatave të rajoneve Kukës, Shkodër, Elbasan e Dibër, Federata Kombëtare paraqiti disa nga rezultatet që kanë dalë nga analizat e punës së bërë në drejtim të qëndrueshmërisë së pyjeve, paqartësitë për sasinë e pyjeve të transferuara, etj. Pastaj diskutuan: Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit, drejtori i PK, Prof. Arsen Proko, drejtori i AITPP në Ministrinë e Brendshme, Bardh Rica, kryetari i Komunës Gjinar, Kristaq Shqahu, shef departamenti në Fakultetin



e Shkencave Pyjore, Ervin Toromani, përfaqësuesit e Sektorit të Pyjeve Komunale, Preng Prenga e Admir Seci, shefi i Shërbimit Këshillimor në DSHP Tiranë, shefi i menaxhimit në DSHP Berat, Fatos Nako, shefi i menaxhimit në DSHP Cërrik, Shyqyri Deliu, kryetarët e Federatave Elbasan e Kukës, etj.

Diskutantët sollën arsyetime të ndryshme për pronësinë dhe të drejtat për përdorim, problematikat për transferimin dhe gabimet e bëra. Analiza e bërë u pranua nga një pjesë e pjesëmarrësve, ndërsa disa kishin kundërshtime për shifrat e transferimit, por nuk sollën shifra të tjera; regjistrimi ishte në shkallën e ulët të njohurive për institucionet. Pika më e dis-

kutueshme ishte njohja e përdoruesve tradicionalë. Katër Federata dhe analiza e bërë nga Federata Kombëtare, sollën shembuj konkret se pyjet në Shqipëri, por dhe kullotat, kanë përdorues tradicionalë, por historikisht u është mohuar drejta e tyre, prandaj duhet të bëjmë përpjekjet e nevojshme për t'u njohur këtë të drejtë banorëve me ligj, me objektiv që të permirësojmë strategjinë dhe të luftojmë informalitetin në këtë sektor jetik. Nga shumë diskutantë të institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile, u argumentuan prioritetet që sjell prona private për pyjet, duke argumentuar edhe mbështetjen që duhet për motivimin e shërbimit për njerëzit

që punojnë në pyje. Nga shumë diskutantë doli evidente mungesa e një inventari të saktë të pasurive pyjore dhe nevoja për permirësimin e evidencave të këtij sektori, etj. Në përgjithësi, të gjitha shqetësimet që vijnë për pyjet, janë komplekse, prandaj dhe përpjekjet e të gjithë aktorëve jo vetëm duhet të jenë më të qarta në Ligjin e ri, por duhet rritur edhe bashkëveprimi në interes të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Disa nga problemet për periudhën informuese

Sektori pyjor ofron punësimin e një pjese të madhe të shqiptarëve, si dhe thith një numër akoma më të madh të fuqisë punëtore, nëpërmjet veprimtarive **informale në pyje**.

Bazuar në kontekstin e vëzhgimeve aktuale, Shqipëria po përballet me humbje të dukshme të kapitalit pyjor. Të dhënat, nga shumë burime, transmetojnë në vazhdimësi të njëjtin mesazh.

Konsumi i druve të zjarrit është identifikuar si një nga faktorët më të rëndësishëm prapa kësaj krize. Normat aktuale të konsumit tejkalojnë nivelet e shfrytëzimit të qëndrueshëm. Ndërkohë që duhet të shqetësohemi që lënda e punimit e cilësisë së mirë për shumë vite shpesh ka përfunduar në lëndë djegëse, duke rritur në këtë mënyrë humbjet social-ekonomike.

Prania e një tregu të fortë informal pengon çdo lloj ndërhyrje nga DPK-ja apo organet e tjera ekzekutive. Për më tepër, ai çrregullon dinamikën e tregut, dobëson përpjekjet për progres teknik, ushqen korrupsionin **në administratën publike dhe në përgjithësi pengon reformat institucionale**.

Në përgjithësi nuk kemi të dhëna të grupuara e të besueshme për gjithë vendin, me një shkallë të lartë qëndrueshmërie, deri në nivel Ministrie, jo vetëm për sipërfaqen e pyjeve dhe volumin e tyre, por dhe për sipërfaqen e pyjeve dhe kullotave të transferuara,

Vijon në fq. 2

Prof. Dr. Arsen Proko, Drejtor i Pyjeve në MMPAU

Objektivi ynë është që nëpërmjet permirësimit të strukturave tekniko-administrative të menaxhimit të pyjeve, të kryejmë reforma e veprimtari që çojnë drejt vënies së ekonomisë pyjore në interes të komunitetit dhe komuniteti, në radhë të parë ai rural, do të përfitojë nga këto burime të ardhurash; pra të ulim varfërinë dhe, natyrisht, të permirësojmë gjendjen e pyjeve. Ky është objektivi ynë dhe ne do të shkojmë drejt këtij objektivi.

Problem tjetër shumë i rëndësishëm mbetet regjistrimi, i cili ka të bëjë me një sërë aspektesh teknike e strukturash shtetërore përgjegjëse, të cilat janë në vështirësi, por

Vijon në fq. 3

Bardh Rica, drejtor i AITPP në Ministrinë e Brendshme

Përvoja tashmë 20 vjeçare, tregon se të gjithë sektorët ku është bërë privatizimi, kanë ecur me ritme më të shpejta se aty ku akoma është akoma pronë publike. E theshë këtë për të dalë tek problemi për të cilin po diskutojmë, tek pronësia mbi pyjet dhe kullotat.

Politika e shtetit është e qartë, pozitive – opozitive, drejt Evropës dhe drejt privatizimit! E majta dhe e djathta janë shprehur për privatizimin dhe politikën nuk kanë ndryshuar kur kanë ndryshuar qeveritë. Pra, mendoj se jemi në rrugën e duhur, nuk kemi pengesa nga politika, por kemi pengesë të ajo se çfarë duhet të bëjmë. Kemi humbur shumë, 20 vjet! A do të

Vijon në fq. 2

Kristaq Shqahu, Kryetar i Komunës Gjinar, Elbasan

Komuna e Gjinarit, komunë malore e rrethit të Elbasanit, për fat të mirë ka pyje, që kanë filluar të rigjallërohen, pas gjithë atyre situatave që kaluam. Fakt është që mjaft sipërfaqe nuk u dëmtuan, të cilat edhe sikur çdo druri t'i kishim venë nga një roje, përsëri shumë do të ishin prerë. Por, në Gjinar është ngjallur dashuria për pyllin dhe kjo ka bërë që të ruhen mjaft mirë. Megjithatë, unë mendoj se duhet të ecim me sloganin "Përparësi në investime atje ku ka dhe mbrohen pyjet". Në komunën e tonë janë transferuar 2835 ha pyje, kryesisht shkurre e pyje të

Vijon në fq. 2

Prof.as. Dr. Ervin Toromani, në Fakultetin e Inxhinierisë Pyjore, Tiranë

Procesi i transferimit të pyjeve e kullotave të komunat, është një realitet, por më ç'shikojmë, paskemi paqartësi në kompetenca midis aktorëve, mosnjohje të kuadrit ligjor dhe, njëkohësisht, në disa raste edhe mungesë fryme bashkëpunimit midis DSHP, në rastin konkret nëpërmjet Shërbimit të Ekstensionit, i cili natyrisht duhet parë, komunës dhe komunitetit. Pra, këto janë disa nga problemet që ndeshen. Tani kalojmë tek aspekti tjetër, duke vazhduar idenë e sapohedhur. Aktualisht, nëse ka biznesmenë ose persona që e duan mjedisin, natyrën, ka raste

Vijon në fq. 3

Pylltaria në Kosovë

Nisma e miqve dhe hapat tanë

Xhavit SADIKAJ, kryetar, Skënder BASHA, anëtar në SHFPPP "Mali", Suharekë

Faqe 4

"Ah" pyjet

Skënder BASHA, teknik pyjesh

Faqe 4

Rorientimi për permirësimin e reformave për pyjet e kullotat komunale

Vijon nga fq. 1

regjistruara. Nuk kemi të dhëna për planin e shfrytëzimeve, për planifikimin e prodhimeve, nevojat për dru zjarri, mundësitë, rritjen vjetore të planifikuar e të realizuar, planifikimin strategjik, etj. (Pramungon një database kombëtare e sektorit pyjor, duke marrë në diapazon të gjerë të aspekteve ekologjike, ekonomike dhe social-kulturore).

Aspekte strategjike

Meqë mungojnë të dhënat e grupuara e të besueshme, planifikimi strategjik, hartim i politikave dhe shpërndarja e mbështetjes publike e ndërkomëtare, pengohen ndjeshëm. Pa ndërgjegjësimin e duhur dhe fushatat informuese, do të jetë e vështirë të paraqitet nevoja për shfrytëzim më të rregullt të pyjeve, si rrjedhojë e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Në këtë kuptim, DPK dhe degët e saj rajonale e lokale duhet të kuptojnë se

detyrat e tyre do të jenë më pak të përqendruara në zbatimin e politikave dhe ligjeve, **sesa në punën si ofrues shërbimesh, partnerë, trajnerë dhe ofrues informacioni e këshillash.**

Duhet të nxiten investimet e brendshme, nëpërmjet sigurisë ligjore në zotërimin e burimeve pyjore, pronësisë private në mjetet e prodhimit, veprimeve dhe taksave administrative të parashikuara dhe sigurinë e kontratave.



Nevoja për një ndryshim të llojit të energjisë së përdorur nga familjet. Marrja e masave ndërsektoriale për zvogëlimin e kërkesës për dru zjarri është shumë urgjente.

Krijimit të plantacioneve për rritjen e shpejtë të druve të zjarrit. Një skemë e tillë duhet të bazohet në kontribute financiare të sigurta, psh, nga krijimi i një fondi. Paratë nga fondi duhet të lihen

në dispozicion të kompanive apo shoqatave që propozojnë programe të përshtatshme pyllëzimi në zonat prioritare. Ndër zonat më problematike për mbrojtjen e tokës është shpallur Shqipëria e Mesme, nga Elbasani në Tiranë e Durrës dhe krijimi i fidanishteve me lloje plepi e të tjera, të cilat janë ndërmarrë por duhet të mbështeten. Afrimi i skemave të financimeve për mbjellje drurësh pyjorë rreth tokave, atje ku nuk prodhohen drurët frutorë. Pyllëzimet në rrugët nacionale dhe rehabilitimi i terreneve të eroduar në basenet e HC dhe rrugëve nacionale.

Përmirësimi i kushteve të kullotjes, kullota të transferohet në NJQV. Përmirësimi i shfrytëzimit të kullotave nëpërmjet shtimit të veprave ujore dhe përmirësime.

Zvogëlimi i kërkesës për dru zjarri, kapërcimi i nivelit të lartë të ekonomisë informale për rritjen e investimeve private, heqja e çrregullimeve të çmimeve (parimi i mbulimit kostove).

Përmirësimi i aksesit në informacionin e tregut.

Çfarë synojmë ...

- Shqipëria duhet të mbështetet me një projekt të ri, që të këtë në fokus vazhdimin e punës së nisur me Ministrinë, NJQV, që është një rrugë e qartë për rehabilitimin e pyjeve dhe veçanërisht e shkurreve dhe arroveve.

- Përfshirja e pyjeve në shërbime mjedisore: a) sekuestrimi i karbonit, b) mbrojtja e tokës nga erozioni, c) ruajtja e ujit.

- Të ecet paralelisht me zbutjen e varfërisë e punësimin e fermerëve dhe mbështetjen e 240 SHPPKK.

- Vazhdimi i procesit të transferimit sipas objektivave të qeverisë, regjistrim, privatizim dhe përmirësimi i akteve ligjore (Ligji i ri).

- Projekti i ri të përshtatet me nevojat që paraqesin SHPPKK dhe skemat mbështetëse për reformën për pronësinë dhe legalizimin e pronarëve tradicionalë.

Federata Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave Komunale

Vijon nga fq. 1

Bardh Rica, drejtor i AITPP në Ministrinë e Brendshme

presim dhe 20 të tjera që pyjet të shkojnë tek pronari? Nuk do t'ia japim me zor pronarit! Transferimi i parë është nga qeveria tek rajoni, Ç'të keqe ka që 12 qarqe të kenë 12 rezervate gjuetie ose 12 rajone atje ku fshatari nuk e merr dot sepse është larg. Ajo pjesë t'i jepet rajonit, të vendosë inxhinierët e pyjeve, të vazhdojë të bëjë projekte, të hartojë strategji. E vetmja strategji që është hartuar në 12 qarqe është strategjia e pyjeve që është hartuar në Lezhë. Kemi hartuar një strategji or zotëri për pyjet dhe ka një dokument strategjik që është miratuar në këshillin e qarkut. Dhe me pyjet ne qarqe mund të hartojmë dokumente strategjike, të cilët përbëjnë strategjinë e gjithë vendit se si do të trajtohen këto pyje. Mbi bazën e këtyre strategjive mund të konkurrohet me fonde strukturore në takimet evropiane dhe të sigurohen fonde nga ato strukturore. Mund të përdoren fondet e komunës, mund të përdoren fondet e qarkut, mund të përdoren fonde nga donatorë, por pa projekte, pa strategji, pyjet do të kenë një fund jo të dëshiruar. Na vinte turp kur kalonim në Maqedoni apo në Greqi para 15 vjetësh; ishte si nata me ditën ... Na vinte turp kur fluturonim sipër Shqipërisë se dallohej gjendja, ndërsa tani gjendja është krejt ndryshe, pak ndryshime ka sepse pyjet kanë filluar falë bujarisë së natyrës që i ka rikrijuar, por dhe mundit e sakrificës së inxhinierëve dhe teknikëve të pyjeve. Unë mendoj që realisht ne duhet të shpejtojmë kohën. Ok-ein e ka

dhënë kryeministri, por ai nuk ka hyrë në detaje, në probleme teknike që duhet t'i zgjidhim ne. Do të privatizohet nga ai që dëshiron të lidhë jetën e tij dhe biznesin me pyjet. Kjo është kaluar shumë mirë tek këshillat e komunave, nuk i është lënë kryetarit. Një kryetar mund të abuzojë me pyjet. Jo! Ja kanë lënë këshillat, vendimet janë të këshillit. Duhet të paraqitet në këshill, në të tria format mund të kalohet, për mendimin tim! Mund të japë këshilli i komunës në pronësi apo në përdorim qytetarit, si të dëshirojë ta marrë, mund t'ia japë qarku, mund t'ia japë edhe qeveria. Pra, të tria format e pronësisë mund të përdoren për t'ia dhënë atij, por individit ne nuk mund t'ia japim me zor, sepse edhe në zbatimin e ligjit për tokën, nuk iu dha toka, ndonëse me një kusht të 91-shit të ishte anëtar i kooperativës ose fermës tha s'e dua tokën. S'iu dha me zor! Iu la e drejta që ai ta kërkojë dhe ta marrë me dokumente dhe ta gëzojë. Unë jam për tokën që të përfshihet në pronësi, për faktin se duke e pasur në përdorim ajo nuk ka vlerë. Duke e pasur në pronësi del në pah vlera reale e pyllit. Pronësia tregon se sa vlerë reale ka një pyll në Sarandë, në Tropojë ..., natyrisht nuk janë të njëjta, variojnë, por nëse do ta kenë në përdorim ai përsëri do të jetë pyll pa një vlerë, që s'i dihet vlera reale e tregut. Tregu është ai që do të tregojë vlerën e saj. Në anën tjetër unë jam për fuqizimin maksimal, policia pyjore, shërbimi pyjor duhet t'i ngajë shërbimit pyjor austriak, gjerman apo francez, bashkë me ligjet, bashkë me kompetencat, bashkë me sanksionet. Por, kurrsesi pyllin t'ia lëmë në dorë një njeriu amator, apo një aventurieri, që e pret, e shkatërron, e djeg.

Edhe tokën bujqësore nuk mund ta tjetërsosh, ti nuk mund ta gërmosh, nuk mund ta bësh tulla, tokës bujqësore duhet t'i ruash destinacionin! Po ashtu dhe për pyjet. Unë them që rruga është e ditur, por duhen mekanizmat e vërtetimit të këtij procesi. Eksperienca flet! Aty ku ka rrethuar një zabel iks fshatar kudo në Shqipëri, pylli për 10 - 15 vjet ndryshoi si nata me ditën me pyllin karshi, që i ndan një gardh si kufi. Kufijtë nuk janë problem, se çdo fshat ka majën e kodrës, ka përroin ku ndahet me fshatin tjetër. Të moshuarit janë dëshmitarë dhe i njohin e po të duash ta futësh në parcelë tjetër; jo - të thotë; është e filan fshati. Janë teknikët e pyjeve, që i njohin më mirë se kushdo tjetër dhe atje ku ka probleme do të jenë dhe gjykatat administrative, të cilat do të japin zgjidhje më të shpejtë sesa këto gjykata që i kanë ripërsëritur tash 20 vjet proceset pyjore. Do të ketë zgjidhje në kohën sa më të shpejtë të mundshme.

Mendoj që duke u angazhuar, gjithsecili sipas kontributeve, sipas pozicioneve që ka; shoqata, komuna, bashkia, ministrinë, do të japin atë kontribut që ky proces të përfundojë. S'ka gjë më të mirë që të transferohet një pronë dhe japin mendime të gjitha ministrinë. S'ka lidhje Ministria e Kulturës ndoshta për këtë punë, por jep mendime, kalojnë nëpërmjet Këshillit të Ministrave. Të gjitha ministrinë japin, duket që është duke u bërë një transferim rutinë, jo or zotëri! Është krejt i përgjegjshëm, është krejt delikat, është krejt transparent në gjithë këtë transferim. Nuk ka ndodhur ndonjëherë të jetë një proces më transparent sesa ky i transferimit që po bëhet.

Vijon nga fq. 1

Kristaq Shqahu, Kryetar i Komunës Gjinar, Elbasan

djegur. Pra, është transferuar në mënyrë selektive. Po ashtu, në pyjet e transferuara, një pjesë e ka përsëri shteti. Njolla, siç i quajnë specialistët, sepse unë nuk jam specialist pyjesh. Ajo që dua të theksoj është se edhe në qendrën e komunës, në Gjinar, gjysmën e pyjeve i ka shteti dhe gjysma janë pyje komunale. Për kufijtë midis fshatrave, nuk është siç u tha këtu se kryetarët e komunave janë sehirxhinj. Përkundrazi, ne jemi përpjekur që ta zgjidhim gjithçka drejtë e të mos kemi qejfmbetje, kemi negociuar disa herë por ende nuk po e gjejmë gjuhën e përbashkët. Unë mendoj se këto probleme nuk zgjidhen gjithmonë nga gjykatat, sepse gjykatat kalojnë disa shkallë, pa llogaritur zvarritjet. Por ne s'do jemi gjithmonë kryetarë, ndërsa fshatarët janë përherë aty dhe i shërbejnë pyllit.

Regjistrimi i pyjeve është një hallkë tjetër, e cila për mendimin tim duhet të bëhet nga ministrinë përkatëse, sepse komunat nuk kanë mjete e specialistë, nuk kanë as fonde për të bërë hartat e gjithë të tjerat. Prandaj, mund ta hartojnë regjistrimin ministrinë dhe atë material t'ua kalojë komunave për sipërfaqet që u ka transferuar. Procesi duhet përshtetuar, por pa bërë gabime, pasi duke i pasur pyjet as shtet e as komunë, disa përfitues, disa të papërgjegjshëm, kanë filluar të vetëquhen pronarë, duke i prerë, djegur apo duke i tjetërsuar. Po ashtu, për transferimin e pyjeve, mungojnë disa akte ligjore e nënligjore, të cilat na i vështirosojnë shumë punët.



Vijon nga fq. 1

Prof.as. Dr. Ervin Toromani, në Fakultetin e Inxhinierisë Pyjore, Tiranë

siç e dimë që po i marrin sipërfaqet pyjore me koncesion dhe nuk po kalohet te privatizimi. Tani, siç e kuptoj unë, pyjet kanë kaluar te komuna dhe, nga komuna do t'ia japim fshatarit me ligj. Pra, nuk po flasim për rastin nëse një biznesmen do ta marrë, ta privatizojë pyllin, pra është tjetër këndvështrim. Atëherë, ajo që doja të thosha lidhur me privatizimin, që është dhe merakut i të gjithëve. E para, ne kemi eksperiencë mbi ndarjen e tokës bujqësore, kemi ligjin 7501, i cili ka krijuar shumë probleme dhe parcelizimi i pyllit ashtu si edhe i tokës bujqësore do të ishte gabim shumë i madh. Për këtë arsye ne e shohim që sektori i bujqësisë pas 20 vjetësh nuk ka dalë nga ajo kllapi ku ra në vitet '90, nuk është intensifikuar, nuk po zhvillohet teknologjia, por po ngelet në disa parcela, disa serra, që nuk është koncepti i bujqësisë ekstensive të zhvillimit dhe ky është gabim! Nëse do ta aplikojmë atë në pyje, duke u bazuar te ky shembull, atëherë jemi gabim! Para disa kohësh, qe ministri në fakultet dhe midis të tjerash, tha: Do të përmendim modelin sloven. Unë javën që kaloi kam qenë në një takim në Banja Luka dhe përfaqësuesi i qeverisë slovene, që ishte i ftuar atje, tha: Ne kemi gabuar me privatizimin dhe duam ta korrigojmë ... Tani, lind pyetja, dakord, do ta privatizojmë pyllin dhe do t'ia japim fshatarit, po sa do të jetë kjo sipërfaqe? Rexhepi bëri një analizë ekonomike, që përmendimin tim nuk qëndron e gjitha, megjithatë logjika është ajo. Atëherë, nëse do të shkojmë drejt privatizimit të fshatari duhet të nisemi nga një logjikë ekonomike, pra ekonomikisht dhe duhet studiuar kjo, sa duhet të jetë sipërfaqja minimale pyjore që një familje që është përdoruesi, nuk është individ, kryefamiljari, por është familja përdoruesi duhet që të mbulojë shpenzimet e veta, duhet natyrisht të fitojë dhe diçka në mënyrë që dhe të riinvestojë te ky pyll, pra duhet një analizë ekonomike e tillë e hollë dhe pastaj të themi dakord, po e privatizojmë, po duhet të japim 5 apo 10 ha kësaj familje, jo 5000 m² ose 0.5 ha, sepse kjo logjikë ekonomike duhet të na orientojë gjithandaj. Pra, kjo është ajo që mendoj unë dhe çfarë duhet bërë, pra duhet që natyrisht të ketë raste të tilla studimore ku të përcaktohet efektiviteti ekonomik i privatizimit të pyjeve, ndryshe do të ishte gabim! Atëherë, propozimi dhe që natyrisht konvergjon edhe me atë që tha specialisti sloven atje, është: Ne duhet që pronare të lejojmë të jetë komuna dhe të drejtën e përdorimit ta ketë

komuniteti dhe ata po e korrigojnë këtë gabim. Kështu dhe ne duhet të vazhdojmë ta bëjmë këtë dhe të vazhdojmë në këtë drejtim edhe te strategjia. Jo ta privatizojmë, t'ia japim fshatarit, por ai të ketë të drejtën ta përdorë atë. Nuk thotë asnjë të mos ta përdorë, por jo ta privatizojë dhe kjo natyrisht po të hyjmë në shkencën tonë të mbarështimit të pyjeve, na humbet konceptin e ngastrës pyjore, të nënngastrës, të menaxhimit e kështu me radhë. Prandaj them që këto gjëra duhet të merren në konsideratë dhe besoj që duhet të jenë aspekte që duhet t'i kënaqin të gjitha palët. Përsa i përket analizës që bën Rexhepi, në njërin nga slide-t merr në konsideratë rritjen vjetore, në të vërtetë nuk merret rritja vjetore, por mundësia vjetore e shfrytëzimit, është tjetër koncept. Dhe besoj dhe në diskutimin atje, disa nga profesorët që janë të vjetër në këtë aspekt, në disiplinën e mbarështimit thanë: Jo rritja vjetore, po mundësia vjetore, është tjetër gjë! Gjithmonë mundësia është të paktën 80% e rritjes vjetore, sepse gjithmonë ruhet një farë rezerve. Nëse e kemi fondin normal, se në rastin tonë konkret nuk e kemi këtë. Tani ne, me ç'shohim, përballemi me shifra. Midis inventarit kombëtar të pyjeve dhe kadastrës kemi një hendek të paparë, pra nuk dimë cila është baza e të dhënave. Prandaj mendoj se para se të bëhet strategjia duhet gjetur cila është gjendja reale, nëpërmjet një inventari. Pastaj, mbi këtë bazë e mbi këto të dhëna të sakta, të bëjmë strategjinë, sepse po vazhduam me këto të dhëna të pasakta, përsëri do të gabojmë. Unë, si pedagog i inventarizimit kombëtar të pyjeve. Mendoj se informacioni që siguron është baza kryesore për strategjinë e zhvillimit në nivel kombëtar. Nuk është plani i mbarështimit, por inventari kombëtar i pyjeve dhe ne duhet të bazohemi në të dhëna të sakta, që të bëjmë një strategji të saktë, përndryshe do të gabojmë e prapë do t'i kthehemi këtij qerthulli.

Endë nuk po dimë dhe ministri e kryeministri po thonë: Ore çfarë kemi? Ju s'po dini sa pyje komunalë keni transferuar, tjetër shifër jep ministria, tjetër ju. Po ashtu edhe përsa i përket rritjes, po kështu edhe përsa i përket strukturës. Pra, duhet sqaruar një paqartësi e tillë! Dhe e fundit, shifrat që jep Federata Kombëtare nuk tregojnë domosdoshmërisht nevojën për një rishikim të platformës dhe reformës në pyje, sepse elementi që merret në konsideratë është vetëm një, lënda drusore për dru zjarri. Sot, prirja ose riorientimi i politikës në sektorin e pyjeve është drejt pagesave të shërbimeve, prandaj projekti i ri duhet të orientohej drejt asaj, sepse pylli nuk është vetëm për të marrë lëndën, por edhe për mbrojtjen e tokës, për klimën, etj., dhe te pagesat e shërbimeve, ky duhet të jetë një ndër riorientimet e sektorit të pyjeve.

Vijon nga fq. 1

Prof. Dr. Arsen Proko, Drejtor i Pyjeve në MMPAU

unë mendoj që ne mund të avancojmë. Nuk jam me atë mendim që ne të presim, njëherë ta regjistrujmë, pastaj të shikojmë se ç'do të bëjmë. Ne mund të ecim paralelisht në ato aspekte, të cilat nuk na prekin thelbin e reformave tona. Psh, siç dihet, shteti transferoi pyllin te komuniteti pa e regjistruar më parë, pra nuk tha shteti do ta regjistroj, pastaj do t'ua transferoj, por e transferoi. Natyrisht, në ato vështirësi që ekzistojnë, kufijtë midis komunave, kufijtë ndarës administrativë, etj., duke futur konceptin e kompromisit, konceptin e ndarjes pa konflikte. Pra, komunat vet ta ndajnë me marrëveshje midis tyre, sepse po të shkojmë drejt atyre që u përmendën këtu, se kush do të jetë arbitri, arbitri gjithmonë në konflikte pronësie është gjykata, pra duhet të shkojmë në gjykatë. Ne kemi shumë komuna sot, të cilat pretendojnë që një pjesë e ka marrë kufiri nga komuna tjetër dhe tani e kërkojnë zgjidhjen nga Ministria. Mendoj se zgjidhjen duhet ta kërkojnë nga gjykata, sepse është ajo që vërteton drejtësinë e një pale kundrejt një tjetre. Sepse po ta kishte këtë Ministria e kishte ndarë mirë që në fillim, pra diçka ka ndodhur që nuk mund të bëhet ai institucioni, i cili e ka bërë këtë gabim, të bëhet edhe ndreqësi i këtij gabimi. Janë ca norma, të cilat ne duhet të na tërheqin vëmendjen që të tregohemi shumë më të kujdesshëm. Edhe ne në drejtori kemi mjaft konflikte midis nesh, lidhur pikërisht me transferimin, sepse kërkojmë që t'i zgjidhim njëherë e mirë gabimet dhe kur kemi mbivendosje të mos kemi regjistrim dy herë të së njëjtës parcele, pra të kemi një filtër, që të saktësojë sa më shumë të jetë e mundur sipërfaqet e transferuara.

Sot diskutohet më shumë për privatizimin, apo usufruct-i. Në fakt, misioni i BB dhe projekti i tij kanë folur qartë për usufruct, pra për dhënien pa qira komunitetit, duke përdorur si instrument gjithmonë përdorimin tradicional, ç'ka do të thotë që parimi është usufruct-i, dhënia në përdorim dhe e thashë qartë që nuk do të ketë më financim nga BB nëse do të lëvizet nga ky parim. Unë nuk kam asnjë alergji dhe jam pro privatizimit në çdo mënyrë, por privatizimi

është një instrument që e kanë përdorur edhe vende të tjera, natyrisht jo me kushtet tona, ndërkohë që vende të tilla siç është vendi ynë, që nuk ka një pronësi të dokumentuar me tapi, ka përdorur gjithmonë mënyrën e përdorimit tradicional, por edhe në ligjin e ri ky do të jetë një objekt diskutimi dhe mund të vendosim që pronari ka të drejtë ta shesë pronën e tij. Në këtë rast shteti është pronar për pyjet shtetërorë dhe komunat për pyjet komunale, pra vendos komuna vet se çfarë do të bëjë me pyjet, sepse ajo vet është pronare. Natyrisht, komuna, si të thuash, është institucioni më afër komunitetit, i cili shikon më me interes komunitetin në radhë të parë. Përveç kësaj, me hartimin e ligjit, lind detyrë ligjore, por edhe për shkak të afatit, hartimi i një strategjie të re për pyjet, pra është objekt edhe strategjia dhe vjen vitin tjetër. Ashtu siç është detyrim ligjor dhe hartimi i një plani kombëtar pyjesh, të cilat, natyrisht, të nisura nga këto analiza, nga këto grupe, që po punojnë dhe analizojnë thellësisht proceset që po ndodhin në pyje, do të japin edhe zgjidhjen më të mirë, në interes të të gjithëve, të komunitetit, të biznesit, të industrisë së drurit, që ka rreth 25 mijë familje, të cilat mbahen nga kjo industri. Pra, në interes të ekonomisë, në interes të rritjes së zonave të mbrojtura, që tentojnë të shkojnë rreth 25 % të territorit. Të gjitha këto, strategjia dhe plani kombëtar i pyjeve do krijojnë një zhvillim të harmonishëm të të gjithë sektorëve, pra jo duke e parë thjesht nga një aspekt i vetëm.

Më i rëndësishëm është informaliteti i sektorit të pyjeve. Ne, zyrtarisht nga INSTAT-i, siç u përmend, për çdo lek të investuar, shtetit i marrim 10. Kjo është shifra zyrtare, por nuk është realiteti! Nga analizat që bëjmë, duke marrë në konsideratë bimët mjekësore, drutë e zjarrit që djeg fshatarësi e të tjera, del e kundërta, që ne realisht japim 7 dhe marrim 1 lek. Pra, jemi sektor shumë eficient, vetëm që mbetet proces informal. Atëherë, çfarë kemi bërë me Shërbimin Këshillimor? Që këtë vit kërkuam të bëhen planet operacionale vjetore, ku komuna futet në proceset e planifikimit të sektorit të pyjeve, brenda pyjeve që ajo ka dhe të paktën sa më mirë që ta demonstrojë këtë tek qeveria për produktet që jep sektori i pyjeve, aq më tepër do marrim investime ... Kështu që duhet parë me syrin e perspektivës, nëse këtu ka disa

përfundime të drejta dhe unë e kam parë me sytë e mi që nëse shkon në luginën e Matit, nëse shkon në luginën e Shkumbinit, nëse shkon në luginën e Devollit, ka një zhvillim të vullshëm të pyjeve, pra komuniteti është bërë shumë i ndërgjegjshëm për t'i mirëmenaxhuar, pa i pasur në pronësi, madje pa i pasur dhe me një dokument në përdorim, po duke e ditur që kjo është një filozofi e kësaj qeverie, që pyjet i takojnë komunitetit dhe i takojnë gjithmonë. Kështu, që kjo është më e rëndësishme, pastaj format janë pjesë të diskutueshme, që gjithsesi nuk mund t'i themi që në këtë çast dhe nuk duhet të nxitohemi, pa pritur dhe përfundimet e grupeve që po punojnë në terren dhe ekspertizave të huaja, të cilat po punojnë bashkë me ne për të përcaktuar rrugët më të mira për zhvillimin e sektorit të pyjeve.

Tani vijmë te shifrat: Natyrisht, Rexhepi (Ndreu), duke pasur parasysh transferimin sa më maksimal të pyjeve, nisat nga ca shifra dhe bën ca analiza, nevojat, kërkesat dhe del në një përfundim. Por, nëse unë e kam një përfundim që përpara, atëherë shifrat detyrimisht do t'i nxjerr aty ku dua unë. Nëse punojmë, domethënë në formën e një approach-i, që të bëjmë një analizë të thellë e pastaj të nxjerrim shifra dhe më pas, mbas shifrave të diskutuara, atëherë kjo do të ishte rruga më e mirë. Psh, unë mbaj një analizë, 43 % e popullsisë, thotë Rexhepi, jeton në zonat rurale, që i bie 1.3 milionë. Atëherë, nëse marrim këtë shifër, gjysma jeton në zonat fushore që përdorin energji elektrike, ku është popullsia më e madhe, dendësia më e madhe? Pra, del që 600 mijë vetë jetojnë në zonat malore, që përdorin dru. Po t'i llogarisim me katër pjesëtarë, dalin mesatarisht 150 mijë familje, që kërkojnë, po themi 1.5 milionë m³dru zjarri. Këtë shifër, po ta pjesëtojmë me dy rritjen vjetore, del se 750 mijë ha pyje plotësojnë nevojat e komunitetit për dru zjarri. Ne i kemi transferuar tashmë 750 mijë ... Atëherë?!

E kam fjalën që nëse nevojat dalin gjithmonë sipas shifrave që paraqiten, shpeshherë dalin më të mëdha sesa rritja vjetore e pyjeve. Ç'do të thotë kjo? Do të thotë që ne t'i mbishfrytëzojmë? Jo! Ne duhet të gjejmë rrugët për të arritur e barazuar balancën dhe unë mendoj që për ta mbyllur fare, jemi në rrugë të mbarë drejt finalizimit të procesit, drejt krijimit të kushteve të favorshme për një pylltari të qëndrueshme. Ndërkohë, dua të them se Projekti i ri i BB do të jetë i kufizuar për shërbimet në ekosistem dhe është shumë e rëndësishme përcaktimi i përdoruesit, në mënyrë që të realizohen mekanizmat e pagesave të shërbimeve në ekosistem. Mendoj që mbrapa jemi tek regjistrimi, tek përdoruesi, tek identifikimi i përdoruesve. Kështu që SNV-ja tani duhet të shprehet qartë lidhur me hapat që do të merren. Është bërë një propozim për krijimin e një grupi ndërministeror, i cili do të vazhdojë, por kemi nevojë që të bëhen përpjekje që të shkojmë drejt një procesi të normalizimit të formave të përdorimit dhe të pronësisë!



Pylltaria në Kosovë

Xhavit SADIKAJ, kryetar, Skënder BASHA, anëtar
në SHFPPP "Mali", Suharekë

Nisma e miqve dhe hapat tanë

Në fillim ishim ne, që po njihnim anët e botës por që nga halle të shumta as që po kërkonim rrugën. Mandej kishte ardhur vëllai (Haki Kola) që na solli mikun (Peter Kampen) dhe pjesë të SNV. Ashtu, lehtë, "pa dhimbje", e lindëm Shoqatën e Familjeve Pronare të Pyjeve Private dhe i dhamë emrin "Mali". Tani jemi një dhe me shikimin drejt së ardhmes. Fare e re në moshë, Shoqata "Mali", hapëron çdo ditë, madje me hapa të mëdhenj, të shpejtë e të sigurt. Edhe të ditur po bëhemi. Mësojmë çdo ditë nga shumë. Kështu, vullnetshëm, do kemi arritje të mëdha. Pse jo? Nuk thuhet kot: "Vëllai është vëlla" dhe "Miku është përkrah Zotit". Ne që tanimë jemi krenarë, duam t'ua kthejmë krenarinë edhe pyjeve. Krahas nesh, po rilindin edhe ato. Kishte vrull, tani ka hov, ka ritëm dhe ecja është përpara, kah e ardhmja.

Janë regjistrat e radhëve, të pronarëve të pyjeve privatë, që zgjaten, takimet e tyre me qëllim ofrimi, njohjeje e bashkimi, për të



Pranë gështenjës eksponat natyrorë, Dolloc, Suharekë

paraqitur subjekt shoqëror që merr nisma e ndryshon rrjedha. Është fjala jonë njëzëri dhe ndikimi në miratimin e ligjit për pyjet, pasuri jona. Këshillimet dhe mbajtja e orëve me qëllim edukimi të nxënësve të shkollave

fillore dhe atyre të mesme - të ulët, si duhet ruajtur e si duhet përkujdesur për mjedisin, me theks të veçantë në "Pylli im", dhe kampingjet e organizuar për këta nxënës, që të njohin më për së afërmi pyllin. Fletëpalosja për Shoqatën "Mali", bisedat kudo dhe angazhimi i përditshëm, të kontaktohen sa më shumë pronarë pyjesh e t'u jepen sa më shumë njohuri mbi rolin dhe rëndësinë që ka pylli, si dhe këshilla për të menaxhuar qëndrueshëm pyjet. Ka edhe shumë pronarë të këtushëm pyjesh për t'u anëtarësuar në Shoqatë dhe shumë punë për të bërë. Shoqata "Mali" dhe shoqatat simotra, kudo në Kosovë, janë bërë faktor, që nuk anashkalohe më.

Sigurisht, do të ketë edhe "mospajtime". Piteri që është aq simpatik, kur "belbëzon" shqipen, i mrekulluar me rrallimin realizuar kohë më parë në pyjet e këtueshëm të ahut, kishte kërkuar mendimin mbi synimin tonë të fundmë dhe, s'ishte mjaftuar me përgjigjen tonë se "Donim pyll të lartë, me dru cilësorë teknikë". Interesimit

të tij se "Cili do të ishte numri i trun-gjeve për hektar, pas dyzetepesë vitesh"? i ishim përgjigjur guximshëm: "Nëntëdhjetenëntë". E, si reagim, që po shprehte mosbesim, do t'i themi: "Ja, vetëm kaq e Jo njëqind. Dhe kjo për të vetmen arsye që të kemi një vend ku mund të na prekë dielli, buzë hijes së rëndë të lisave, qirinj, të gjatë". Ishim te "Maja e Ahishtës", mjedis që të ekzalton e të bën skajshmërisht krenar, andaj "endë nuk e dimë se kush kishte të drejtë", ndërsa këtë e kishim thënë nisur nga "fakti" që pyjet tona janë pyjet më të mira në botë.

Mjedis siç ka ditur të krijojë natyra, e në te shtrihen gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë hektarët tanë, të pyjeve, strukur nën sqetullën e po më shumë pyjeve tona të përbashkëta, pasuri kombëtare. Shumësi bimësh e laramani llojesh, vet parajsja në tokë. Se e duam pyllin nuk diskutohet. Tani jemi të zotët t'i qëndrojmë edhe më pranë.

"Ah" pyjet

Skënder BASHA, teknik pyjesh

Pyjët me të drejt shpallen pasuri kombëtare. Ato janë pasuri me vlera të veçanta për njerëzit e çdo vendi. Ndër të tjera, rëndësia e pyjeve është edhe ekonomike edhe sociale, ngase me të mirat e shumta që japin ndikojnë drejtpërdrejt në këto aspekte.

Pyjet e Kosovës, ishin fatkeqe në gjithë të kaluarën e tyre dhe kjo për dy arsye: E para, ngase gjatë gjithë së kaluarës shfrytëzoheshin nga pushtete të huaja, për to e për njeriun e këtushëm. Dhe, e dyta, ngase njeriu i vendit, pronar legjitim i tyre, asnjëherë nuk qe në gjendje e në pozitë t'i menaxhojë qëndrueshëm. Vendi i pushtuar, pos të tjerash, i kishte bërë njerëzit edhe të varfër e tepër të varur nga pylli, ndërsa s'kishin as minimumin e njohurive për përkujdesje ndaj tyre; po ashtu, u mungonin kushte të shfrytëzimit racional e me nikoqirllëk të tyre. Si pasojë këtyre dy faktorëve, që të thuash vetëm këtu po bashkëvepronin. Sot kemi pyje skajshmërisht të dëmtuara e krejtësisht të degraduara, ndërsa pasojat janë dukshme e të njohura.

Sipërfaqe të tëra u zhveshën e u shkretuan, duke i shndërruar në toka pyjore ose edhe më keq në toka djerr, krejt të pashfrytëzuara, që për pasojë kishin varfërimin edhe më të popullatës, kurse e tëra kjo po shoqërohej edhe me dhunë krejt të shfrenuar të aparatit shtetëror serb mbi popullatën, me qëllimin e fundit që kësej popullate t'i bëhej jeta krejt e padurueshme e të shpërngulej përfundimisht nga këtu.

Gjendja në pyje është një nga treguesit e gjendjes së shoqërisë në plan arsimimi e kulture, ndërsa pasqyron edhe vetëdijen dhe mundësitë e organizimit shoqëror e politik të saj. Këtu s'mund të na lihet i tërë

faji, por duhet marrë e pranuar pjesën e fajit që na takon. Krejt kjo me qëllim përmirësimi të gjendjes në pyje dhe të ecjes përpara, si shoqëri e tani edhe si shtet, drejt së ardhmes.

Në fundshekullin e kaluar, veçmas në prag të luftës për çlirimin e Kosovës, gjendja në pyje, si në çdo plan tjetër, ishte rënduar edhe më shumë. Si të thuash, kishte marrë përmasa "tragjike". Pushtuesit, duke e parë se sundimit të tyre në Kosovë po u vinte fundi, ishin lëshuar në prerjen dhe shfrytëzimin e pyjeve jashtë çdo rregulli e norme ligjore, vetëm e vetëm të grabisnin çka mund të grabitej. Po planifikoheshin prerje enorme të drurëve në pyll, ndërsa kishte edhe prerje të shumta të paplanifikuara, që po shoqëroheshin me prerje, t'i quajmë ilegale, të cilat po bëheshin nga njerëz të pushtetit okupues serb, shqiptarë e serb, dhe me bekimin e përkrahjen e tyre, ngase secili prej tyre po përfitonte ose po zhvaste diçka. Të shumta ishin edhe prerjet rrah, të cilat ishin bërë dukuri dhe i hasje kudo. Dëmet ishin të papërshkrueshme e të pallogaritshme. Kjo jo vetëm për faktin që po priheshin e shfrytëzoheshin egër, por mungonte edhe minimumi i përkujdesjes së shfrytëzimit racional, ngaqë sasi e shumë e këtij druri, me vlera të larta teknike, i cili do të mund të shfrytëzohej në industrinë e drurit, shfrytëzohej si dru zjarri.

S'kishte fare kuadro profesionistë, ose edhe kur kishte, ai ishte shqipfolës ose thjeshtë serb i predisponuar të zhvaste dhe s'kishte as ndjesinë më të vogël për pyllin e s'ndjente keqardhje për veprimet e zhvillimet skajshmërisht të dëmshme për pyjet, për mjedisin e për të ardhmen e njerëzve këtu. Stafii udhëheqës, kudo në

komunën e Suharekës, edhe ai që po menaxhonte me pyjet e kësaj komune, ishte i emëruar nga komiteti i partisë, që për dekada me radhë po na nëpërkëmbte në çdo aspekt. kombëtar, shoqëror dhe qytetar e njerëzor, ndërsa punonin për pushtetin e tyre ose për interesa grupesh a klanesh, meqë po qeverisej në gjendje anarkie të plotë; ata përkraheshin nga shqipfolës të përzgjedhur, sahanlëpirës, të cilët ia kishin shitur shpirtin ose i ishin dhënë të tërë djallit.

Për ndonjë investim në këto pyje, në atë kohë, as që mund të flitej. Kjo për arsyet e shumta që përmendëm, po më së tepërmi për faktin se që të gjithë mekanizmat shoqërorë e shtetërorë pos menaxhimit të dobët me këto resurse e pasuri kombëtare, i ishin rrekur vjedhjes dhe keqpërdorimit të tyre, ku secili mernte e zhvaste atë që mundte. Ishin kohë të liga, kur e tërë pasuria e këtij populli ishte në duar të shpërdoruesve, të cilët praktikisht s'po dinin të ngopeshin. Fati i pyjeve me asgjë s'po ndryshonte nga fati i popullit. Rrethanat në prag të luftës dhe ato të luftës së fundit, ishin ato që ndërprejnë këtë dëm pyjor e këtë grabitje të madhe. Edhe më pas, kishte dëme, por tani i shkaktonte popullata krejtësisht e dëmtuar nga lufta.

Në pasluftë jeta kishte marrë rrjedhën dhe kishte ritëm në këtë rrjedhë, por ja që njerëzit s'po udhëhiqeshin nga mbarësi. Të shumta e nga më të ndryshmet ishin zhvillimet e dukuritë negative kudo në shoqërinë kosovare. Do të shohim se ne na mungon arsimit e më shumë kultura e vetëdija, veçmas ajo kolektive dhe për gjëra e pasuri të përbashkëta e interes kombëtar. Pyjet kanë domethënie e jetës, kurse ne, me sjelljen tonë, i kemi bërë edhe këto, një nga dhembjet tona të mëdha.



Supozoj, dhe dua të besoj se e tëra lidhet me gjendjen sociale të njeriut ynë e në shoqërinë tonë. Them se s'ka të tillë që vërtet duan të dëmtojnë pyjet e këtë mjedis kaq të mrekullueshëm që kemi. Përmend se punonjësve të këtushëm u ka ardhur në majë të hundës: Zënia e pritave dhe konfliktet me palët, shpesh edhe duke ua konfiskuar drutë e duke i dënuar me gjoba, që vështirë se mund t'i paguajnë, ngase me të vërtetë shumica e këtyre dëmtuesve janë varfanjakë. Duhet të jemi në kërkim të zgjidhjes, të një zgjidhjeje të përhershme. Mendoj se të punësosh njerëzit do të thotë të sigurosh e të vësh në binarë gjithçka. Asgjë s'është e lehtë, por ne duhet të ecim më tej. Sado që jemi pas kombeve të përparuara, së paku duhet shkuar pas tyre, ndërsa duhet synuar t'i arrijmë e të ecim përkrah tyre, për të jetuar në harmoni të plotë njeriu dhe mjedisi, përfshirë pyjet. S'guxojmë të pranojmë situatat pa rrugëdalje dhe zgjidhja duhet gjetur në menaxhimin e qëndrueshëm me masa silvikulturore dhe në pajtimin e kundërshtive, duke plotësuar nevojat e të dy palëve, të pyllit në një anë, për ta mirëmbajtur dhe të popullatës, në anën tjetër, për furnizim me dru për djegie.

Të thërrasim ndërgegjen e të krijojmë vetëdijen përditë nga shumë (jo nga pak). Jemi të vonuar. Të mos vonohemi më. Jeta le të rrjedhë me ritmin që i diktojmë ne dhe, gjithsesi, në kahun që i tregojmë ne - kah e ardhmja e ndritur. Pse jo?

Rekomandimet kryesore

a) Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave, proces i domosdoshëm dhe çështje kombëtare. Për shkak të shërbimeve të gjera mjedisore, që ofrojnë zonat pyjore e kullimore, kërkohet rritja e përgjegjësi për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të tyre. Prandaj, regjistrimi i titujve të pronësisë së pyjeve e kullotave duhet të merret si çështje e veçantë. Problemet e pronësisë, regjistrimi i pronave pyjore/kullimore të transferuara duhet të vlerësohen si prioritet kombëtar dhe teknik. Prandaj, kërkohen zgjidhje politike dhe financiare për të siguruar që 20 % e sipërfaqes së vendit tonë të menaxhohet në mënyrë sa më efektive. Është e nevojshme përfshirja e shumë aktoreve kyç, si Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, Ministrinë e MPAU, Ministria e Drejtësisë (ZRPP), drejtuesit lokalë, organizatat civile përfaqësuese të shoqatave të pyjeve dhe mjedisit në të gjitha nivelet.

b) Regjistrim paraprak, mbështetur në vendimet e KM, dhe lista e pronave të bazuara në të dhënat e kadastrës pyjore, për të formalizuar pronarin e ri dhe përgjegjësitë. Duke pasur parasysh sasinë e punës, nivelin dhe detajet, burimet teknike e financiare të nevojshme për regjistrimin e pronave të transferuara nga shteti tek NJQV, për më shumë se 300 komuna e bashki, që mbulojnë mbi 740.000 ha tokë (mbi 20 % e vendit), është e nevojshme të gjendet një zgjidhje brenda një kohe të shkurtër. Disa përgjegjësi ligjore për menaxhimin duhet të jenë të përcaktuara qartë, duhet një regjistrim paraprak i pyjeve e kullotave transferuar në bazë të vendimit të KM, në ZRPP dhe NJQV të njohin përgjegjësitë e tyre të reja ligjore. Ky regjistrim formal duhet të bazohet në listat që janë në dispozicion të pronave bashkëngjitur me vendimin juridik të bazuar në kadastrat të pyjeve dhe hartave (1:25,000 ose 1:10,000 shkallë) në mënyrë që të formalizojnë pronësinë e re dhe përgjegjësitë.

c) Regjistrimi fillestar i pyjeve dhe kullotave, në bazë të kërkesave të ligjit dhe udhëzimit përkatës, mundëson çdo ndryshim të mëvonshëm. Pas regjistrimit fillestar formal, bazuar në kërkesat e plota teknike e ligjore të procesit të regjistrimit (duke përfshirë hartën në shkallën e kërkuar) mund të bëhen ndryshime të mëvonshme. Në sistem mund të paraqiten ndryshimet në përdorimin e tokës (për antenat, gazsjellësit, guroret, etj.), të pronësisë së një komune, bashkie apo individit, të cilat mund të rishikohen përfshirë shkallen e hartës, kufijtë ndarës, etj., duke përdorur sistemin unik të numrave të pronave.

d) Angazhim i qarte për një bashkëpunim më të ngushtë midis palëve të interesuara dhe autoriteteve rregullatore, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, atë të Brendshme dhe atë të Mjedisit Pyjeve e Administrimit të Ujërave. Palët duhet të krijojnë një grup pune për regjistrimin e pyjeve, të përditësojnë udhëzuesin për regjistrim dhe të sigurojnë komunikim të mirë midis ZRPP e subjekteve që regjistrojnë pasuritë që kanë marrë. Udhëzuesi i parë "Për regjistrimin e pyjeve e kullotave" i vitit 1999 duhet të përditësohet, duke reflektuar ndryshimet në teknologji e cila duhet të behet gjerësisht e disponueshme për NJQV, me qëllim që ato të jene në dijeni të kërkesave të regjistrimit. Një program ndërgjegjësimi/informimi duhet të zhvillohet për NJQV në nivel rajoni dhe të koordinohet nga qarku.

e) Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për NJQV, përsa u përket detyrimeve ligjore dhe përgjegjësi. Për të siguruar kuptim më të plotë të roleve e përgjegjësi dhe detyrimet juridike të përcaktuara me vendim të KM, kërkohet një fushatë ndërgjegjësimi për të mbuluar të gjitha komunat e bashkitë. Kjo mund të organizohet në nivel qarku, me përfshirjen e plotë të kryetarëve të qarqeve, prefektëve dhe ZVRPP.

f) Qarku/NJQV të kenë ekspertë dhe pajisjet e nevojshme teknike për të menaxhuar të dhënat hapësinore të territorit. Procesi i regjistrimit nuk duhet të konsiderohet si procedurë, por investim në menaxhimin efektiv të burimeve pyjore/kullimore dhe të tokës në përgjithësi. Shtohet nevojja për një kadastrë digjitale në nivelin e qeverisjes vendore (bile ZK) jo vetëm për regjistrimin e pyjeve dhe kullotave, por edhe për menaxhimin e të gjitha pronave të tjera të paluajtshme. Kjo do të mundësojë të realizohen planifikime afatgjata të mbarështimit të territorit, të regjistruar në të gjitha marrëveshjet me përdoruesit lokalë

Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të NJQV-ve

PROBLEM I VËSHTIRË APO I NEGLIZHUAR?

Gjon FIERZA, Specialist për pyjet në DSHP, Tiranë - Janaq MALE, Specialist për pyjet në SNV, Tiranë

të tokës dhe pyjeve, kontratat për vendosje të antenave, për minierat dhe guroret, etj. NJQV u kërkohet që të emërojnë specialistë pyjesh në administratë, për të marrë rolin e menaxherit të pyjeve e kullotave. Shërbimi Pyjor Shtetëror në nivel qendror, duhet të punojë në ndërtimin e kapaciteteve të stafit për rolin e këshilltarit për të asistuar menaxherët e rinj, si dhe në fuqizimin e funksioneve rregullatore dhe monitorimin e gjendjes.

g) Vazhdimi dhe thellimi i procesit të decentralizimit në aktorët lokalë. Procesi i transferimit të pyjeve e kullotave në pushtetin lokal duhet të vazhdojë më tej, jo vetëm me përmirësimet e VKM për shtesa e ndryshime të sipërfaqeve pyjore/kullimore, por me transferimin e këtyre pasurive tek përdoruesit tradicionalë. Kalimi në pronësi nga titulli në përdorim tek fshatari është një vendim politik. Kryeministri në fillim të këtij viti ka nënvizuar procesin e privatizimit të pyjeve e kullotave, duke nënkuptuar pikërisht kalimin në pronësi tek përdoruesit tradicionalë të tyre. Për t'u zbatuar ky kalim pronësie kërkohet të gjenden rrugët të ofrohen dhe diskutohen procedurat ligjore dhe teknike, bashkëpunim i palëve për sukses në këtë proces.

Rekomandime më të hollësishme

1. Rëndësi e veçantë duhet t'i jepet regjistrimit fillestar të pyjeve e kullotave nga qeveria lokale për zbatimin e vendimeve të Qeverisë për transferimin e aseteve. ZRPP është agjencia kryesore në bazë të ligjit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe e ngarkuar për të udhëhequr e menaxhuar këtë proces si dhe të sigurojë në fund të procesit dokumentacionin përkatës të pronësisë/përdorimit (certifikatë e pronësisë/përdorimi). Kjo kërkon jo vetëm njohuri të legjislacionit por dhe të akteve të tjera, të drejtat dhe detyrimet për sa i përket regjistrimit në ZRPP. Në këtë kuptim, ka rëndësi të madhe për t'u arritur bashkëpunimi me NJQV, cilat duhet të jenë kërkesat dhe standardet teknike të aplikuara nga këto zyra për të regjistruar pronat. "Udhëzuesi i regjistrimit fillestar të pyjeve dhe kullotave" të vitit 1999, i përditësuar duhet të vihet gjerësisht në dispozicion të NJQV në mënyrë që të jenë të vetëdijshëm për kërkesat e regjistrimit.

2. Procesi i regjistrimit fillestar të pyjeve e kullotave, të fillojë sa më parë, duke shfrytëzuar përvojën e fituar deri tani nga regjistrimi i tokës bujqësore, banesave apo dhe i atyre sipërfaqe të vogla pyjore të futura në SRPP. Rekomandojmë që kjo punë të realizohet nga subjekte apo individë të specializuar, që kanë kryer regjistrime fillestare të tokave bujqësore dhe banesave.

3. Kur ka mospërputhje në sipërfaqe ose kanë mbivendosje në zonat kufitare mes NJQV, kërkohet bashkëpunim i tyre. Janë kryesisht kryetarët e fshatrave kufitare së bashku me specialistët e kadastrës në komuna ata që duhet t'i saktësojnë këta kufij dhe përkatësinë e



sipërfaqeve pyjore e kullimore që është përdorur tradicionalisht nga secili fshat. Kur palët nuk bien dakord duhet të jenë strukturat drejtuese të qarkut që t'i zgjidhin.

4. Puna për pyjet dhe kullotat, që do të transferohen nga shteti tek NJQV, si rezultat i rishikimit të listave të inventarit ekzistues, kërkohet të behet sa me pare për ti paraprire regjistrimit fillestar të tyre në ZVRPP. Ky proces rishikimi kërkon bashkëpunimin e NJQV midis tyre dhe me DSHP, për saktësim përfundimtar të listave.

5. Ndërsa shumë NJQV kanë filluar të rekrutojnë specialistë të pyjeve në rolin e tyre për menaxhimin e këtyre pasurive, Shërbimi Pyjor Shtetëror duhet të investojë në ndërtimin e kapaciteteve të stafit, me qëllim që të përshtaten me rolin këshillimor për menaxherët e rinj, si dhe të plotësojë rolin e tij rregullator e monitorues.

6. NJQV duhet të ketë personel të specializuar, që të ndjekë zbatimin e planeve të menaxhimit për pyjet e kullotat, për të bërë marrëveshje me përdoruesit lokalë dhe familjet e veçanta, përgatitje e ndjekje të programeve të zhvillimit, etj. Digjitalizimi i kufijve të fshatrave (ZK), procedurat për regjistrimin fillestar të pyjeve/ kullotave komunale, që janë transferuar në pronësi/ përdorim të NJQV në ZRPP, mund të kryhet vetëm nga subjekte të specializuara për regjistrimin e pasurive. Kështu është vepruar për regjistrimin e tokës bujqësore dhe banesave. Kërkohen fonde të konsiderueshme për këtë proces regjistrimi. Qeveria shqiptare (nëpërmjet Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) deri tani e ka mbështetur procesin e regjistrimit fillestar të tokave bujqësore me financime të donatoreve. Diskutimi behet a do të funksionojë përsëri kjo formë financimi për regjistrimin fillestar të pyjeve e kullotave, apo do mbulohet nga ZRPP apo nga vete NJQV. Prandaj duhet një vendimmarrje nga Qeveria që të zgjidhet ky problem.

7. Përdorimi i metodave bashkëkohore të informacionit hartografik, programeve e softwareve të posaçëm duhet të jete një nga prioritetet e mëdha. Përdorimi i ortofotove të prodhuara nga fotografimi ajror i viteve të fundit do të krijojë lehtësi teknike për rilevimet pyjore, përcaktimin e kufijve të ndarjeve administrative të NJQV dhe ZK. Përdorimi gjerësisht i tyre do të mund të zgjidhe shumë probleme, që lidhen me territorin në përgjithësi dhe pyjet në veçanti. Përdorimi i ortofotove ka saktësi, ka kosto të ulët, ato sot po përdoren me sukses në normalizimin e ndërtimeve pa leje në gjithë vendin.

8. Nevoja e një kadastrë digjitale gjithëpërfshirëse në nivel NJQV, del si domosdoshmëri jo vetëm për procesin e regjistrimit të pyjeve e kullotave por dhe për administrimin e gjithë pasurive të tjera natyrore të NJQV. Kjo do t'i shërbente pushtetit vendor për menaxhimin e të gjitha aseteve të kontraktuara me shfrytëzuesit lokalë apo jashtë komunës.

9. Organizimi dhe menaxhimi i një baze qendrore të dhënash digjitale do të ishte arritje e madhe dhe faktor i rëndësishëm për zbatimin e politikave të suksesshme në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave në nivel kombëtar. Shërbimi pyjor, komunat që kanë në pronësi pyje e kullota duhet të krijojnë një baze të dhënash reale për pyjet dhe kullotat shtetërore e komunale. Kjo do të kërkonte një inventarizim të plote e të saktë, që do të shërbente për një vendim optimal për zbatimin me sukses të politikave dhe menaxhimin e tyre.

SNV, Organizata Holandeze për Zhvillim, në bashkëfinancim me Ambasadën Suedeze në Tiranë, prej kohësh po mbështet zhvillimin dhe forcimin e menaxhimit të pyjeve e kullotave komunale, nëpërmjet aftësimin të aktorëve lokalë (komune, shoqate, përdorues). Një nga drejtimet kryesore të kësaj mbështetjeje ka qene asistimi i komunave për të përgatitur dokumentacionin e duhur për të bere regjistrimin e pyjeve dhe kullotave që kanë marrë me VKM, në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive. Po ashtu, kjo mbështetje synon identifikimin e përdoruesve dhe pasqyrimin e tyre në dokumentacionin e regjistrimit.



Dy dhurata për ditëlindjen: çertifikata e "Mirënjohjes" dhe gazeta "Illyria"

Një ditëlindje me tri shifra

Çdo ditëlindje ka bukurinë e vet, pasi është rast për t'u mbledhur e gëzuar, si dhe për të urrear njeriun e afër. Por, çdo ditëlindje ka edhe të veçanta, të cilat mbeten në kujtesë. Kështu edhe ditëlindja e sivjetme e inxhinierit të vjetër të pyjeve, Efthim Naumi, kishte të veçantat e saj. Një nga ato ishte se ajo përmbante tri shifra. Ai festonte ditëlindjen e 101-të! Janë të pakët njerëzit që festojnë ditëlindje me tri shifra. E veçanta tjetër ishte se atë ia festuan së pari banorët e pallatit ku ai jeton me djalin e tij, Gencin. Ishte diçka e papritur për ne kur Genci na tha se do të vini në fillim të merrni pjesë në drekën që kanë organizuar për babanë, banorët e shkallës. Së bashku me dardharin, Sotir Pani, mik i vjetër i Efthimit, shkua aty, në hijen e pemëve, ku ishte organizuar ditëlindja. Tok me banorët e shkallës, e uruam edhe ne Efthimin. Pra, torta e parë me shifrën 101, u pre aty për Efthimin. Është e dyta herë që ata i festojnë ditëlindjen. Për herë të parë ia festuan vitin e kaluar, kur mbushi 100 vjet. Siç na tha Genci, do t'ia festojnë sa të jetë gjallë.



Pas dhënies së çertifikatës së "Mirënjohjes"

Dreka e ditëlindjes me njerëzit e familjes vazhdoi te shtëpia e vajzës së tij, Donikës. Efthimi e ka dashur gjithmonë natyrën, prandaj edhe ditëlindjen ia festuan aty, nën hijen e pemëve. Vajzat, djemtë, nipërit, mbesat e stërmbesat, trokitën gotat me Efthimin, duke i urrear shëndet dhe ditëlindje të tjera së bashku. Dy momente të veçanta pasuan më tej. I pari ishte dorëzimi i çertifikatës së "Mirënjohjes", dërguar nga Shoqata e Inxhinierëve të Pyjeve të Shqipërisë, firmosur nga kryetari i saj, Kolë Malaj, me motivacionin: "Emri dhe kontributi juaj në pylltarinë shqiptare, vlerë dhe shembull për brezat e specialistëve të pyjeve". Mendoj se duhet falënderuar kjo Shoqatë për gatishmërinë që tregoi për të dhënë këtë vlerësim. E mbështetën atë edhe specialistët me emër në fushën e pyjeve: Haki Kola, Gjon Fierza, Mehmet Metaj e Vezir Muharremaj. Vlerësimi për specialistët e vjetër të çdo fushe, është vlerësim për punën dhe kontributin e tyre. Mbi të gjitha, është respekt dhe kulturë! Duhet theksuar se ky mendim iu përcoll më parë Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve e Administrimit të Ujërave, por ajo heshti, duke mos dhënë asnjë përgjigje, qoftë edhe negative. Kur mëson këtë fakt, vetiu lind pyetja: Si mund të vlerësojë pyjet një ministri që nuk vlerëson njerëzit që u kanë kushtuar jetën pyjeve?! Por, le ta lemë me kaq këtë, pasi meriton një trajtim të veçantë.

Çast tjetër i veçantë i kësaj ditëlindjeje ishte dorëzimi i gazetës "Illyria", e cila botohet në New York për shqiptarët e Amerikës. Te kjo gazetë ishte botuar një shkrim për punën dhe jetën e Efthimit, me rastin e 101 vjetorit të lindjes. Kryeredaktori i gazetës, Ruben Avxhiu, i kishte kushtuar dy faqe këtij shkrimi së bashku me fotografitë. Shkrimi ishte botuar ditën e premte, më 29 qershor, për të mbërritur në festimin e ditëlindjes së tij, e cila do bëhej të nesërmen, më 30 qershor, botuesi i gazetës, Vehbi Bajrami, e kishte nisur gazetën me postë të shpejtë. Duke dorëzuar gazetën, i përcollëm Efthimit dhe familjes, urimet e botuesit dhe redaksisë së saj. Efthimi dhe fëmijët e tij falënderuan Shoqatën e Inxhinierëve të Pyjeve të Shqipërisë dhe kryetarin e saj, për dhënien e çertifikatës së "Mirënjohjes", si dhe botuesin e redaksisë e gazetës "Illyria" për botimin e shkrimit dhe dërgimin e gazetës. Një telefonatë urimi nga larg, nga Petraqi, djali i madh i Efthimit, i cili jeton në Gjermani, ia shtoi gëzimin kësaj ditëlindjeje.

Në fund, 101 vjeçari, preu tortën e dytë me numrat 101. Festofsh edhe ditëlindje të tjera, i dashur Efthim!

Në 101 vjetorin e lindjes

Efthim Naumi

"Muze i gjallë" për pyjet tona

nga Fuat MEMELI, Boston, SHBA

Një rastësi

Në gusht të vitit të kaluar, në qytetin e Bostonit, u njoha me një specialist më emër të fushës së pyjeve, inxh. Efthim Naumin. Ndër të tjera, mësova se më 28 qershor ai kishte festuar 100 vjetorin e lindjes. Ishte vonë për të shkruar për punën dhe jetën e tij. Mendova që shkrimin ta botoj me rastin e 101 vjetorit të lindjes. Dhe, ashtu bëra.

Deri tani, si specialist të vjetër, të gjallë, të fushës së bujqësisë e pyjeve, dija agronomin Dhori Laci. Vitin e kaluar, Ministria e Bujqësisë dhe Shoqata "Devolli" i festuan atij 100 vjetorin e lindjes (ka lindur me 20 korrik 1911). Por, ja që Efthimi ia kaluaka në moshë. Ai është edhe 22 dit më i madh se Dhori. Është një rastësi e bukur se të dy këta specialistë, janë me origjinë nga Devolli: Dhori nga Grapshi, ndërsa Efthimi nga Hoçisht. Rastësi tjetër është se të dy kanë mbaruar Universitetin "Aristoteli" në Selanik, njëri për agronomi e tjetri për inxhinier pyjesh. Por, le ta lemë Dhorin. Për atë është shkruar e folur mjaft. Sot e ka radhën Efthim Naumi.

Shkollimi

Hapat e parë të shkollimit të tij zënë fill në vendlindje, në Hoçisht. Aty kreu tre vite të shkollës fillore, pastaj vazhdoi në Greqi, ku e merr me vete vëllai, Petroja, i cili ishte vendosur në Veria. Aty Efthimi vazhdoi shkollën gjashtëvjeçare. Në Korfuz mbaroi gjimnazin gjashtëvjeçar, ndërsa studimet e larta i kreu në Universitetin "Aristoteli" të Selanikut, të cilin e mbaroi në vitin 1939. Kishte filluar Lufta e Dytë Botërore dhe si shumë shkolla, u mbyll edhe ky universitet. Një pjesë e punonjësve të tij shkuan në luftë. Drejtuesit e Universitetit ia lanë Efthimit kujdesin për godinën. Më jepni një vërtetim, që ta



Efthimi student



Duke folur në një konferencë

kem si dokument, u kish thënë atyre Naumi. Ti je shqiptar dhe kemi bindje në besën tënde, i ishin përgjigjur ata. Kështu, për një vit ai qëndroi aty dhe u kujdes si për shtëpinë e tij, për Universitetin ku kishte studiuar.

Vështrim i shkurtër mbi punët e tij të shumta

Në janar të vitit 1942, kthehet në Shqipëri dhe filloi punë në Fushë-Arrëz, që ishte një qendër e madhe pasurish pyjore. Lënda drusore e kësaj zone shfrytëzohej nga shoqëri italiane e shqiptare. Aty Efthimi merrej me damkimin e lëndës drusore, llogaritjen e vullmeve, kontrollin e prerjeve dhe pastrimeve, mbrojtjen e pyjeve nga zjarri e abuzimet, etj. Pas tre vjet pune, transferohet në detyrën e shefit të seksionit teknik të pyjeve e sharrave të Tiranës, që përfshinte zona pyjore edhe në rrethet Durrës, Krujë e Elbasan. Vitet e para të pasqirimit, vendi kishte nevojë të mëdha për lëndë druri. Prandaj, së bashku me një grup të vogël inxhinierë pyjesh, Efthimi punoi me përkushtim për përbushjen e detyrave. Pas Tiranës, në vitin 1946 transferohet në prefekturën e Korçës, si administrator i sharrave për rrethet Korçë, Pogradec e Kolonjë, ndërsa më pas në seksionin e Bujqësisë dhe Pyjeve të Korçës. Edhe aty u mor me planifikimet, mbrojtjen e pyjeve nga zjarret e abuzimet, me krijimin e fidanishteve pyjore, pyllëzimin e kodrave të Korçës dhe atyre të Dëmbrovës në Poloskë të Devollit, me ngritjen profesionale të rojtareve dhe punëtorëve të fidanishteve, etj. Nevojat për inxhinierë pyjesh, bëjnë që Efthimin ta lëvizin sa në një detyrë në tjetrën. Kështu, në qershor të vitit 1949 caktohet shef seksioni në Ndërmarrjen

Industriale të Sharrave në Tiranë. Aty u mor me sigurimin e lëndës drusore për hidrocentralet mbi lumin Mat, sigurimin e traversave për hekurudhat Tiranë-Durrës e Durrës-Elbasan, duke shfrytëzuar pyjet e lisit në rrethet Mirditë dhe Elbasan. Në këtë periudhë, ai ka pasur shqetësime nga njerëz keqdashës, të cilët shpifnin, duke thënë se ka bërë abuzime në pyje. Por,

Administrimit të Pyjeve të këtij qarku. Në këtë ndër-marrje punoi me përkushtim deri sa doli në pension, në qershor të vitit 1974. Ndër punët e shumta të kryera në ato vite, Efthimi kujton ato për zgjerimin dhe pasurimin e fidanishteve pyjore me kultura të reja, duke siguruar fidanë jo vetëm për qarkun e Korçës, po edhe për të tjerë: mbrojtjen e pyjeve të pishës



Familja e Efthimit kur ishte i vogël në Hoçisht (ai me shigjetë)

pas verifikimeve, doli se ato ishin shpifje dhe atë vit u transferua në Drejtorinë e Përgjithshme të Pyjeve pranë Ministrisë së Bujqësisë. Edhe aty me ngarkesë të madhe pune: merrej me studime për pyllëzimet e reja, drejtoi punimet për gjelbërimin e plazhit të Durrësit me plepa, pisha e eukalpite, me projektimin dhe ndjekjen e punimeve për gjelbërimin e bregdetit nga Durrësi në Kavajë e deri në Kumet e Vlorës; studion mundësinë e mbjelljes së plepit kanadez në rrethet Vlorë, Fier, Lushnjë, Durrës, Lezhë e Shkodër për sigurimin e lëndës për prodhim letre; punoi për ngritjen e fidanishteve në disa rrethe të vendit, etj. Gjurmët e punës së Efthimit në ato vite i gjen edhe në gjelbërimin e parkut "Rinia" në Tiranë, si dhe para hotel "Dajtit" me fidanë të sjellë nga Italia, etj.

Puna e specialistëve të pyjeve në ato vite ishte e madhe, kujton Efthimi, pasi numri i tyre ishte i pakët. Mund të përmend këtu specialistët me emër, të diplomuar jashtë vendit, si Ilia Mitrush, Lllazar Treska, Ilia Nako e ndonjë tjetër. Më pas u dërguan studentë në Bullgari, Rumani, BS, etj., u çel edhe Fakulteti i Pyjeve dhe numri i tyre erdhi duke u rritur.

Me kërkesën e tij, në shtator të vitit 1955, transferohet në qarkun e Korçës. Në fillim punoi në seksionin e Bujqësisë e më pas kryeinxhinier i Ndërmarrjes së

nga procesionaria; pyllëzimet në Devoll e rrëzë malit të Moravës; gjelbërimin e spitaleve, kopshteve, çerdheve e objekteve industriale; gjelbërimin e rrugëve Korçë-Bilisht, Korçë-Pogradec, Korçë-Kolonjë, etj. Në studimet e tij të publikuar në mjaft artikuj (numërohen 45 artikuj të botuar) Efthimi ka mbrojtur tezën e përhapjes së kulturave me rritje të shpejtë, ndërtimin e brezave pyjorë mbrojtës për kulturat bujqësore, zgjerimin e arealit të pishës së zezë, si halore me rëndësi, që zhvillohet në toka të varfra, etj. Shpesh studimet e tij janë kthyer në vendime qeverie.

"Sekreti" i jetëgjatësisë dhe dy fjalë për familjen

Tek bisedonim me Efthimin dhe fëmijët e tij për "sekretin" e jetëgjatësisë së këtij njeriu që vazhdon të mbahet mirë, me gjithë vitet që ka mbi supet, ata na shpjeguan disa prej tyre. Natyra e qetë, jo nervoze, ka qenë një nga këta faktorë. Puna për shumë vjet me pyjet, në këtë oaz të gjelbër, një sekret tjetër i jetëgjatësisë së tij. Ngrënia ngadalë dhe përtypja mirë e çdo ushqimi, ka ndikimin e vet. Edhe muhalebinë e ka përtypur. Jeta e mirë familjare, gjithashtu ka ndikuar në jetëgjatësinë e tij, na

Vijon në fq. 7

Reorientation for Improvement of reforms of Communal Forests and Pastures

National Federation of Communal Forest and Pastures in collaboration with SNV Albania and supported from many other organizations and associations, in 20 July 2012 organized a roundtable meeting with a topic for discussion related to developing reforms of Communal Forest and Pastures in Albania. The aim of this activity is the discussion of findings from research and today's practices, as well as the concretization of steps that need to be undertaken for the continuation of reforms (transfer, registration, necessary legal improvements) to ensure the sustainability of Forests and Pastures in Albania.

After discussions by federations of regions Kukës, Shkodër, Elbasan, and Diber, National Federation of Communal Forest and Pastures presented some of results that have emerged from analysis of work that is done in terms of sustainability of forests in regions, uncertainties about the amount of transferred forests, analysis in relation to the population and sector's priorities.

After the presentation, discussed representatives of Ministry of Environment, director of Forests and Pastures, mr.ArsenProko; Ministry of Interior, director of AITIP (Agency of Inventory and Transfer of Immovable Property), mr.Bardh Rica; representative of Ministry of Finance, mrs.Irina Canso; Head of Gjinarr commune, mr.KristaqShqahu; Chief Department of Forests of the Faculty of Forest Sciences, mr. Elvin Toromani; representatives of the Directory of Communal Forest, mr.PrengPrenga, AdmirSeci; Chief of Advisory Service at the Directory of Forest Service Tirana, mr.GjonFierza; Chief of Management Office at Directory of Forest Service Berat, mr.FatosNako; Chief of Management Office at Directory of Forest Service Cerrik, mr.ShyqyriDeliu; Head of the Federation of Elbasan, Kukës etc.

From discussants was presented different reasoning about the ownership and the rights of using, transfer problems and mistakes that are made. The analysis made was accepted by a part of participants, some of them had objections related to digits of transferred forest, but they didn't brought their digits, the transfer process was in the low scale of knowledge for the institutions. The most discussed point was the recognition of traditional users. Four federates and the analysis made by National Federation brought up specific examples that forests in Albania but even the pastures have their own traditional users and historically their rights on them is denied, therefore we must do all the needed efforts to recognize this right of inhabitants through the law with the aim to improve the strategy and to fight the informality in this vital sector. Many discussants from the State Institutions and Civil Society argued the priorities that bring private ownership of forests by arguing the support needed for the motivation of service for the people that work in forests. By many discussants was emerged clearly the lack of an accurate inventory of Forest assets and prioritization of problems, improving evidences of the sector etc. In general, all the concerns that come about forests are complex, therefore the efforts of all stakeholders not only must be clear in the new law but must boosted the interaction on interest of sustainable management of natural resources.

Some of problems for the informing period:

Forest-based sector offers employment of a large part of Albanians and it gathers an even larger number of workforce through **informal activities in forests**.

Based in the context of current observations, Albania is facing with

considerable losses of forest's capital. The data from various resources continuously transmit the same message.

Fuel wood consumption is identified as one of the most important factors behind this crisis. Current consumption rates exceed the levels of the sustainable exploitation. Meanwhile, we should worry that the good quality timber for many years often has ended as fuel wood by increasing in this manner the socio-economic losses.

The presence of a strong informal market inhibits any kind of intervention from the Directory of Forest and Pastures (DFP) or other executive organs. Moreover, it distorts the market dynamics, weakens the efforts for technical progress, **feeds the corruption in the public administration and inhibits institutional reforms in general**.

Generally, we don't have grouped and reliable data for the whole Albania with a high rate of sustainability until at ministry level, not only for the forests area and their volume but even for transferred and registered forests and pastures area. We do not have data for the exploitation plan, for the production planning, needs for fuel woods, possibilities, annual growth planned and realised, strategic planning etc. (So is missing a national database of forest-based sector, considering the wide diapason of ecological, economic and socio-cultural aspects).

Strategic aspects

Information, knowledge

Like emerged even from analysis, there are no available grouped and reliable data for the whole Albania, with a high rate of sustainability until at ministry level, and without that, the strategic planning, policies drafting and delivering of public and international support are inhibited significantly. Without the needed awareness and



informing campaigns will be hard to be displayed the need for a more regular exploitation of forests and as consequence even the sustainable management of natural resources.

In this meaning, DFP and its regional and local branches must understand that their duties will be less focused on policies and law implementation than on services offering, partnership, trainers, and information and advices provider.

Must be stimulated the domestic investments through legal security about forest resources possession, private ownership, producing means, activities and administrative taxes predicted and security of contracts.

The need for a change of the kind of energy used by households

Taking of inter-sectorial measures for fuel wood, demands reduction, **very urgent**.

Creating of plantations for fast growth of fuel woods

Such a scheme should be based on secure financial contributions, for instance from creating of a fund. The money from fund should be left in the disposition of companies or associations that propose appropriate afforestation programmes at the priority areas. At the problematic areas for land protecting is announced Middle Albania from Elbasan to Tirana, Durres and creating of nurseries with poplar and other species are undertaken but

Page 8 ➔

Vijon nga fq. 6



Me bashkëshorten, Sofinë

thonë fëmijët e Efthimit. Shërbimi mjekësor amerikan ka pjesën e vet në jetëgjatësinë e tij, sidomos 18 vjetët e fundit, që ai jeton në Amerikë. Bashkëshortja e tij, e ndjera Sofi, ka qenë grua ideale dhe krahi i djathtë i Efthimit, jo vetëm kur ai ishte në punë, po gjatë 60 vjetëve që kaluan bashkë. Është vendi të themi dy fjalë për bashkëshorten e tij. Ajo ishte me origjinë nga Luarasi i Kolonjës. Kishte lindur në Amerikë, në Boston, ku

ishte pagëzuar nga Fan Noli. Në moshën 6 vjeçare ishte kthyer me prindërit në Shqipëri. Këtu mbaroi shkollën amerikane të Kavajës. Ajo doli partizane dhe u mësonte atyre abece-në. Në vitet e para pas Çlirimit, punoi për hapjen e disa shkollave. Në profesionin e mësuesit punoi deri sa doli në pension. Çifti Naumi lindën e rritën katër fëmijë, dy djem e dy vajza: Nikoletën, Petraqin, Donikën dhe Gencin, të cilët mbaruan studimet e larta, duke u bërë njëri më i mirë se tjetri. Dashurinë për pyjet, Efthimi e ka rrënjësor edhe tek fëmijët. Ata të flasin gjatë për këtë fushë, sikur të kenë vazhduar shkollë për pyjet. Ka qenë shkolla e babait, që i ka rrënjësor këto njohuri. Njërin nga fëmijët e tij, Petraqin, e bëri inxhinier pyjesh. Qysh kur isha i vogël, babai më merrte me vete në shërbimet që bënte në sektorët pyjorë. Shpesh unë kam fjetur aty, tok me babanë, thotë Petraqi. Më



Me djemtë, Petraqin dhe Gencin

fliste vazhdimisht për pyjet dhe ma rrënjësi dashurinë për 'ta. Ai ndikoi që unë të vazhdoja këtë fakultet, thotë Petraqi, i cili tani jeton në Gjermani.

Dy herë i mbrojtur nga pylli

Si çdo njeri, edhe Efthimi ka pasur çaste të rrezikshme në jetën e tij. Ato i kanë hedhur "rrënjë" në kujtesë dhe nuk i harron. Është rastësi që të dy çastet e vështira të jetës së tij, lidhen me pyllin.

Rasti i parë: Kishte qenë në një rreth me shërbim

dhe po kthehej në shtëpi me autobus. Nga një pakujdesi e shoferit, autobusi u përmbys, duke bërë dy-tre rrotullime, por fatmirësisht nuk përfundoi në humnerë. E mbrojti një pemë. Pati vetëm disa plagosje. Efthimi shpëtoi për mrekulli. Nga ajo ngjarje, atij i lindi ideja që të pyllëzohen anët e rrugëve, jo vetëm për hije e bukuri, po edhe që të mbroheshin makinat nga aksidentet. Për këtë qëllim shkroi edhe një artikull. Hartoi disa projekte për mbjelljen e drurëve pyjorë anës rrugëve, të cilat i vuri në jetë. Tek shkruaj këto radhë për këtë ngjarje, që ka lidhje me Efthimin, më shkon mendja te aksidenti tragjik që ndodhi sivjet afër Himarës, ku humbën jetën 11 vajza. Shpresoj të jenë nxjerrë mësim nga strukturat përkatëse në Shqipëri, që krahas masave të tjera, të vazhdojë tradita e mbjelljes së drurëve pyjorë anës rrugëve automobilistike.

Rasti i dytë: Kësaj here ishte në pyll. Kishte shkuar për punë. Papritur, koha u prish. Qielli u bë pus dhe filluan shkreptimat. Nga errësira që u krijua dhe shiu i madh që filloi, mund të binte në një humnerë. Por ..., në çast shkreptiu dhe, nga drita e saj, devijoi ecjen e nuk ra në humnerë. Pylli, të cilin e ka dashur dhe e do aq shumë, e mbrojti edhe kësaj here.

Një propozim në vend të mbylljes

32 vjet punë të pandërprera, të bëra me përkushtim, në emër të profesionit, që i kushtoi jetën, në emër të dashurisë për pyjet, për t'i shtuar e mbrojtur ata, për të shtuar gjelbërimin e qyteteve, për t'ua bërë jetën njerëzve më të bukur e më të shëndetshme, mbart mbi supë personazhi i këtij shkrimi. E, për të gjitha këto punë, ai ka marrë fjalë të mira endonjë

fletëlavdërimi dhe vetëm kaq. Inxhinieri 101 vjeçar, mendojmë se e meriton një vlerësim nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nga prefektura e Korçës, ku ai ka lënë gjurmë të shumta me punën e tij, apo nga bashkia e këtij qyteti, në territorin e së cilës gjithashtu blerojnë frytet e punës së tij.

Efthim Naumi, e meriton një vlerësim edhe nga Presidenti i Republikës, por, siç dihet, aty është radha e gjatë e nuk i vjen dot atij. Një dëshmi "Mirënjohje" nga Ministria e Mjedisit apo bërja "Qytetar Nderi" i Korçës, do të ishte një "shlyerje borxhi" sado e vogël, ndaj këtij "muzeu të gjallë" të pyjeve tona. Do të kishte një domethënie të bukur vlerësimi sivjet i këtij vërsniku të Pavarësisë. Për të tjerët, më të rinj, vlerësimet presin, ndërsa për atë jo, pasi jeta bën të vetën ...

Boston, qershor 2012

Reorientation for Improvement of reforms of Communal Forests and Pastures

need to be supported. Absorption of new financial schemes for planting of forest trees around the lands, in that part where the fruit trees cannot grow up. Afforestations on the sides of national roads and the rehabilitation of eroded terrains at Hydro Power basins and National roads.

Improvement of grazing conditions, Pastures to be transferred to Local Government Units (LGU)

Improvement of utilization of pastures through adding of water places where the livestock can get water.

Reducing of fuel wood demand, exceeding of high informal economic level for boosting of private investments, removal of price distortions (principle of costs coverage)

Improvement of access on the market information

What is our Aim?

Albania must be supported with a new project, which must be focused on continuing of started work with the Ministry, LGU, that is a clear path for forest rehabilitation and especially of shrubs and nuts species.

Including of forests into environmental services: a – carbon seque-



stration; b – land protecting from erosion; c – underground water protection.

To be moved forward in a parallel manner with poverty reducing and farmers employment and supporting of 240 Associations of Users of Communal Forest and Pastures (AUCFP)

Continuation of transfer process according government's objectives, registration, privatization and improvement of legal acts (New Law).

The new project must be adapted on the needs presented by AUCFP and the supporting schemes for the reform of ownership and legalization of traditional owners.

National Federation of Communal Forest and Pastures

Page 1, 2

Bardh Rica: Today, forest engineers administrate 60 to 70% of the area; unprotected in forest, under the snow, rain etc. They have done as much as they could, naturally unsupported from nobody. Today comes that moment that forest engineers with endless forests, their salaries are lower than teachers, where truly there are forest engineers at the commune, there are at the municipality, there are in the district, there are even in all the institutions and their role must be increased, also the salary and authority through the law as they are technical managers, who will develop the forests. The left and the right sides of the political parties are expressed about the privatization and the policies have not changed when the political rotation of governance is made. So, we are in the right path, we don't have barriers from policy, but we have a barrier to that what we should do. We have lost too many years, 20 years! Are we going to wait even other 20 years that forests go to their owner? We are not going to force the owners to accept forests! The first transfer is made by government to the region. What's wrong if 12 districts have 12 hunting reserves, or 12 regions where the farmer cannot take it because it's too far? That part needs to be given to the region, to engage the forest engineers, to continue doing projects and planning strategies. The only strategy that is drafted in 12 districts is the Forest Strategy that is drafted in Lezha district. We have drafted a strategy for the forests and there is a strategic document that is approved in the district council. And with forests, we the districts, can draft strategic documents, 12, which constitute the strategy of Albania related to how will be treated these forests. On the base of these strategies could be competed with structural funds in European meetings and to provide funds from structural funds. Commune's funds can be used, district's funds also, can be used funds from donators, but without projects, without a strategy forests will have an undesirable end.

Page 1, 2

Kristaq Shqahu (head of Gjinar commune): I come from a mountainous commune of Elbasandistrict, fortunately this is a commune that has forests. I do not agree with the existing skepticism about the transfer of forests, for the reason because as if to each wood to be put a forest guard they still would be cut, but in Gjinar is the affection about forests that protects them. However, representatives of ministry of environment, of various ministries, I appeal you that the slogan of 2000's years "Development in exchange of weapons" to be swapped it with the slogan "Priority the investments where there is forests and are protected". In Gjinar commune are transferred in total 2835 ha of forests, but that what I notice is that are transferred shrubs and scorched forests. So it's transferred in a selective manner, firstly and secondly in the transferred forests, a part of them is still owned by the state, spots as the specialists call them because I am not a forest specialist. That what it is and I want to emphasize is: we have the center of Gjinar that is also the center of the commune an half is owned by the state and the other half by the commune. Borders between villages, not like Gjon said that the chairpersons of the communes are useless. We have negotiated several times and we are not finding the compromise language, but if we go through that path that professor said, in courts, we won't be able to love forests anymore.

Page 1, 2

Arsen Proko, Director of Forest and Pastures directory: Today is discussing more about privatisation or usufruct. In fact, World Bank's mission and its project has spoken clearly about the usufruct, so for giving with no rent to community, by using as instrument always the traditional usage, what means that the principle is usufruct, giving in usage and I said it clearly that won't have anymore financing from WB if will be moved from this principle. I am pro privatisation in every manner, but the privatisation is an instrument that is been used even in other countries, natyrrally not with our conditions, meanwhile other countries like our country, that have not a documented ownership with land patent, have always used the manner of traditional usage, but even in the new law this will be a discussion subject and we may decide that the owner has the rights to sell his property. In this case the state is owner of state forests and communes are owners of communal forests, so commune itself decides what is going to do with the forests, because it is the owner. Naturally, commune is the nearest institution to the community, which sees the community with more interest. In addition, with the drafting of the law, arises a legal duty, but even because of the deadline, to develop a new forest strategy, so it is object even the strategy and it comes by next year. As it is a legal obligation the drafting of national plan of forests, starting by these analysis, by these groups that are working and analysing deeply the processes that are occurring in forests, will give the best solution on the interest of all, to community, to business, to wood industry that has about 25.000 families that work in this industry. So, on the interest of the economy, on the interest of expanding of protected areas that tend to go at about 25% of the territory. All these, the strategy and the national plan of forests will create an harmonious development of all sectors, thus by not seeing it only in one aspect.

Page 1, 3

Ervin Toromani: So, that what I wanted to say regarding to the privatization fact that is even the concern of everyone and it's been heard here today. Firstly, we have an experience on agricultural land sharing, we have the 7501 law, which has created too many problems to us and the fragmentation of forests in the same manner as agricultural land would be a very big mistake. And for this reason we are seeing today that the agricultural-based sector yet, after 20 years has not emerged out of that situation where it fell in 90's years, it's not intensified, it's not developing its technology etc. but it is remained in some plots, in some greenhouses that is not the extensive agricultural developing concept and this is a mistake! If we would apply that in forests basing on this example, then we are wrong! We should allow the commune to have the rights of ownership and the community to have the rights of use. Secondly, as it is been discussed earlier in this table about annual growth and the possibility of annual yield, they are two different things. Always the possibility is at least 80% of annual growth, because always it is left a sort of reserve, if we have a normal forest fund, though in our case we don't have it. Now as we see we are facing with digits. There is a big gap between national inventory of forests and cadastre, so we don't know which the base of data is. And I am saying to the professor Arsen, you are doing a strategy, you are wrong! You must find out, which is the real situation and do an inventory! Let's see what we got and on these accurate data let's do the strategy, because if we keep going with these incorrect data we will be wrong again with the strategy and this is the A. And we don't know now, minister and prime minister are saying: What do we have? You don't know how much communal forest have transferred, different digits the ministry and different digits you! The same thing as regards to growth, the same thing as regards to structure, so this gives a total obscurity and such an obscurity must be clarified. Today the trend or policy reorientation in the forest-based sector is toward barriers of services and here it is the professor and the new project must be oriented toward it, because forest is not only to take the wood material but it also plays a great role in land protection, climate change, and in other problems. This must be one of the reorientations of forest-based sector.

Page 1, 3

Khavit Sadikaj, chairman, Skënder Basha, member at SHFPPP "Mali", Suharekë

At the beginning were we, that were recognizing the world's sides, but because of a lot of troubles we neither, were searching the path. Then had arrived our brother (Haki Kola) that brought to us the guest (Peter Kampen) and parts of SNV. So, slowly "with no pains" we raised the Association of Owners Families of Private Forests and we gave it the name "Mountain" moving forward everyday even with big, fast and safe steps. And we are becoming wise. We learn a lot every day. Thus, willing we will have great achievements. Why not? Isn't it said "Brother is brother" and "Friend is beside the God". We that already are proud, want to give the pride back even to the forests. Along with us, are regenerated even those. Had vigor and now has jerk, has rhythm and the moving is forward, toward the future...

Page 4

"Ah" forests SkënderBasha, forest technician

Forests rightly are declared a national asset. They are an asset with very special values for the people of every country. Inter alia, their importance is economic and social, because with the multiple goods they give impact directly on these aspects. Kosovo's forests were unfortunate in the whole their past and this for two reasons: First, because over all their past have been exploited from conquerors for them and for the people here. Secondly, because the man of land, who is the legal owner of the forests, never was in the position to sustainably manage them. The conquered country, among others had made the people even poor and very dependent on forests, while they didn't have the minimum of knowledge to look after forests; as well there was a lack of conditions for their rational exploitation.

Page 4

Faqet 7, 8 i përshtati në anglisht Arjol LILA

KURORA E GJELBËR

Gazetë e FKPCK, Shqipëri dhe e APPK, Kosovë

Këshilli Botues: A. Proko, N. Çollaku, V. Tabaku, J. Male, B. Gashi, I. Zeka, B. Hoxha
Kryeredaktor: AHMET OSJA **Zv.kryeredaktorë:** Nijazi IDRIZI, Ferdin LIÇAJ, Albora KACANI
Redaksia: V. Muharremaj, H. Kola, Gj. Fierza, M. Shehi. **Redaktor përgjegjës:** V. Hoxha
Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina e ZP, kati II, Tiranë

Mobile: 068 40 75 975; **e-mail:** fkpkk@hotmail.com; velihoxha@yahoo.com

www.fkpkk.org
www.akppp.org

SNV
Connecting People's Capacities

EMBASSY OF SWEDEN
Tirana